



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 65/16 prot.

Tiranë, më 05.12.2025

**VENDIM**  
Nr. 70, datë 05.12.2025

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 44, DATË 24.07.2024**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 44, datë 24.07.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Divjakë dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës",

**KONSTATOVA SE:**

Me urdhrin nr. 48, datë 09.09.2024, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në Bashkinë Divjakë", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, në institucionin Bashkia Divjakë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 44, datë 24.07.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Divjakë dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës", ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, me Urdhrin nr. 61, datë 02.07.2025, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues

nr.44, datë 24.07.2024, të Komisionerit”, Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 44, datë 24.07.2024, në institucionin Bashkia Divjakë, sipas drejtimeve të programit të mbikëqyrjes në vazhdim nr. 651/1, datë 02.07.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar institucionit me shkresën nr. 651/2, datë 02.07.2025, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit nr.44, datë 24.07.2024 të Komisionerit”. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes dhe në përfundim të procesit mbajti një akt konstatimi ku u pasqyrua situata e rregullimit të ligjshmërisë dhe u administrua dokumentacioni që materializon zbatimin pjesërisht të vendimit objekt i këtij verifikimi.

Më tej, me qëllim lehtësimin e procesit dhe sigurimin e një zbatimi sa më efektiv të detyrave të përcaktuara, është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me njësinë përgjegjëse të subjektit, si nëpërmjet korrespondencës elektronike, ashtu edhe përmes komunikimeve telefonike, duke ofruar asistencën e nevojshme për sqarimin e paqartësive të hasura gjatë procesit të zbatimit të plotë të vendimit të Komisionerit.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 44, datë 24.07.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në **pikën 2**, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësinë përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, si komiteti i vlerësimit, analisti i punës dhe eprorët direkt, të përfundojnë klasifikimin racional të pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë dhe klasën e zbatueshme për secilën kategori, në përputhje me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr. 152/2023, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe pikës 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, duke ndjekur procedurën, sipas orientimeve në përmbajtje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes. Në përfundim të këtij procesi njësinë përgjegjëse të hartojë dhe miratojë planin e rekrutimeve në shërbimin civil.

Nga aktet e administruara gjatë verifikimit në subjekt, konstatojmë se, me Urdhin nr. 393, datë 03.10.2024, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur i punës për mbledhjen e informacionit për pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, për përcaktimin e detyrave, përgjegjësisë, kërkesave të çdo pozicioni, për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të përgjithshme të punës për çdo kategori, klasë dhe grup pozicionesh.

Më tej, me shkresën nr. 7942 prot., datë 30.10.2024, njësinë përgjegjëse ka kërkuar nga drejtoritë e institucionit të Bashkisë Divjakë të dërgojnë pranë grupit të punës, informacionin e përgjithshëm për përshkrimet e punës.

Gjithashtu, me Urdhrin nr. 488, datë 31.12.2024, të Kryetarit të Bashkisë Divjakë, është ngritur Komiteti i Vlerësimit dhe Klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil.

Në vijim, grupi i punës i ngritur për mbledhjen dhe analizimin e informacionit mbi pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, me shkresat nr. 7646 prot., datë 23.07.2025; nr. 7646/1 prot., datë 26.9.2025; nr. 7646/2 prot., datë 20.8.2025 dhe nr. 7646/3 prot., datë 20.8.2025 ka përcjellë pranë Sekretarit të Përgjithshëm dhe Komitetit të vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil, dokumentacionin për vijimin e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të shërbimit civil.

Me shkresën nr. 11423/1 prot., datë 03.12.2025, "*Informacion mbi hapat e ndërmarrë referuar vendimit paralajmërues të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil*", regjistruar pranë Komisionerit me nr. 639/5 prot., datë 05.12.2025, Bashkia Divjakë, ka informuar këtë të fundit se procesi i hartimit të përshkrimeve të punës për të gjitha pozicionet që përfshihen në shërbimin civil ka përfunduar plotësisht, duke u hartuar dhe miratuar për çdo pozicion pune.

Në pikën 3, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, të rregullojnë paligjshmëritë e konstatuara. Të anulohet procedura e lëvizjes paralele për pozicionet e punës: "*Specialist i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*"; "*Specialist Veteriner dhe Mjedisi*", dhe "*Specialist Inxhinier*", nga momenti i vlerësimit të kandidatëve për dokumentacionin dhe i njoftimit të kandidatëve të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit, atë të intervistës së strukturuar me gojë. Në këtë rast, të rregullohen pasojat duke anuluar aktet administrative në kundërshtim me ligjin. Komisioni i Brendshëm për lëvizjen paralele, duhet të realizojë fazën e dytë të procedurës së lëvizjes paralele dhe të hartohen dhe administrohen në dosjen e rekrutimit aktet e nevojshme administrative që dokumentojnë kryerjen e kësaj faze. Sipas ligjit, gjatë procedurës së rekrutimit, anëtarët e KPP-së duhet të plotësojnë formularin, përmes të cilit deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me kandidatët pjesëmarrës në konkurrim, si dhe të respektojnë të gjithë hapat e tjerë procedural.

Nga këqyrja e akteve, rezulton se:

- Me Urdhrit nr. 259, datë 24.7.2025, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Komisioni i Brendshëm për lëvizjen paralele në kategorinë ekzekutive.
- Përmes Urdhrit nr. 120, datë 25.03.2025, të Kryetarit të Bashkisë, punonjësit Enoil Hila në pozicionin "*Specialist Inxhinier*" i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare për shkak të ligjit (*për arsye se ka kryer një vepër penale*). Në këto kushte, objekti i kërkimit të Komisionerit për këtë rast është bërë i pamundur.
- Me aktin nr. 6354 prot., datë 7.7.2025, janë shpallur për t'u plotësuar në përputhje me ligjin pozicionet e punës "*Specialist Inxhinier*" dhe "*Specialist i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*", me aktin nr. 6354/1 prot., datë 7.7.2025, është bërë njoftimi për shpallje për procedurën "*Lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil, kategoria ekzekutive*", pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
- Me shkresën nr. 12177 prot., datë 3.12.2025 "*Informacion mbi vijimin e zbatimit të rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil*" Bashkia

Divjakë ka informuar se me aktin nr. 259, datë 24.7.2025, është zhvilluar procedura e lëvizjes paralele për pozicionin “Specialist Veteriner dhe Mjedisi”.

Në pikën 4, Komisioneri ka kërkuar që të përmbillet periudha e provës duke respektuar të gjitha kërkesat e nenit 24 të ligjit për nëpunësin civil, si edhe të aktit nënligjor që rregullon këtë institut të ligjit, duke nxjerrë aktet administrative që materializojnë procedurën e kërkuar, për 7 punonjës.

Rezulton se:

1. I.Malko, i cili mbante pozicionin “Specialist IT”, me aktin nr. 179, datë 29.4.2024 është larguar me dorëheqje;
2. B.Snalla, “Inspektor i Mjedisit dhe Emergjencave Civile”, me aktin nr. 5, datë 6.1.2022, i është shkëputur marrdhënia me shërbimin civil, ky pozicion tashmë është jashtë administrimit të shërbimit civil;

Në momentin e verifikimit në subjekt në akt konstatimin e mbajtur nga grupi i punës është konstatuar se për 5 punonjësit e tjerë nuk ishin marrë masa të mëtjshme për zbatimin e kësaj pike. Në kuadër të komunikimeve të vijueshme me njësinë përgjegjëse të kësaj bashkie Komisioneri është vënë në dijeni me shkresën nr. 12177 prot., datë 3.12.2025, se janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në pikën 4 për punonjësit E. Davidhi, A. Simaku, J. Lala, M. Leka A. Simaku si dhe S.Toshkallari, duke i deklaruar si nëpunës civilë pas përfundimit të periudhës së provës.

Në pikën 5 Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Divjakë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit, për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në këtë ligj, në pozicione pune të kategorisë ekzekutive, që aktualisht janë 15 raste, të evidentuara nominalisht më poshtë dhe të rregullojë pasojat, me qëllim që në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës pranë AKPA, për t’u plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni të jetë efektivisht i lirë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të Komisionerit nga ana e institucionit të Bashkisë Divjakë rezulton se në zbatim të kësaj pike të vendimit paralajmërues janë marrë masat si më poshtë:

1. Me Urdhrin nr. 319, datë 23.08.2024, “Për Largim nga Detyra”, të Kryetarit të Bashkisë, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare për punonjësin Romeo Leka, në pozicionin “Inspektor mjedisi”;
2. Me Urdhrin nr. 423, datë 14.11.2024, “Lirim nga Detyra”, të Kryetarit të Bashkisë, janë ndërprerë marrëdhëniet financiare për punonjësen Silvana Sako, në pozicionin “Inspektor mjedisi”;
3. Me aktin nr. 6401/26 prot., datë 27.09.2024, në përfundim të procesit të konkurrimit është emëruar në pozicionin “Specialist Jurist”, Shaban Konja;
4. Me aktin nr. 7896/31 prot., datë 24.12.2024, në përfundim të procesit të konkurrimit është emëruar në pozicionin “Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në NJA”. Manushaqe Leka;

5. Me aktin nr. 7896/30 prot., datë 24.12.2024, në përfundim të procesit të konkurrimit është emëruar në pozicionin "*Inspektor Vlerësimi dhe Kontrolli*", Romario Meço;
6. Me aktin nr. 7896/29 prot., datë 24.12.2024, në përfundim të procesit të konkurrimit është emëruar në pozicionin "*Specialist i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit*", Marinela Perriu;
7. Me aktin nr. 7896/28 prot., datë 24.12.2024, në përfundim të procesit të konkurrimit është emëruar në pozicionin "*Specialist Auditit*", Rudjan Çuli;
8. Me aktin nr. 6354 prot., datë 07.07.2025 është shpallur për t'u plotësuar në përputhje me ligjin pozicioni i punës "*Specialist i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit*", si dhe me aktin nr.6354/1 prot., datë 07.07.2025 është bërë njoftimi për shpallje, pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
9. Me aktin nr. 695 prot., datë 8.7.2025 është shpallur për t'u plotësuar në përputhje me ligjin pozicioni i punës "*Specialist i Statistikave Vendore*".

Në përfundim të vlerësimit të kryer, rezulton se institucioni ka ndërmarrë veprime të plota për rivendosjen e ligjshmërisë vetëm në 9 nga 15 rastet e konstatuara si të paligjshme.

Në pikën 6 Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Divjakë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në këtë ligj, në pozicione pune të kategorisë së ulët, të mesme apo të lartë drejtuese, që aktualisht janë 8 raste, të evidentuara nominalisht më poshtë dhe të rregullojë pasojat, ashtu si është orientuar në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, me qëllim që në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës pranë AKPA, për t'u plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e rekrutimit dhe mobilitetit në shërbimin civil.

Konstatojmë se në zbatim të kësaj pike janë marrë masat si më poshtë:

1. Me aktin nr. 6394 prot., datë 08.07.2025, është shpallur procedura për pozicionin "*Përgjegjës Sektori i Veterinarisë, Agronomisë dhe Mjedisit*";
2. Me aktin nr. 233, datë 7.7.2025, është realizuar procedura e rekrutimit për pozicionet "*Përgjegjës Sektori Zbatimit të Projekteve dhe Investimeve*"
3. Me të njëjtin akt është shpallur dhe pozicioni "*Përgjegjës Sektori Inxhinierisë, Monitorimit të lejeve dhe Mbrojtjes Menaxhimit të Tokës*";
4. Me Urdhrin nr. 150/1, datë 30.04.2025, është liruar nga detyra dhe i është ndërperë marrëdhënia financiare me institucionin e punonjësit A. Sula, në pozicionin "*Drejtor*" në Drejtorin e Bujqësisë, Mjedisit dhe Ujitjes;
5. Me Urdhrin nr. 424, datë 15.11.2024, ë është liruar nga detyra dhe i është ndërperë marrëdhënia financiare me institucionin e punonjësit D. Spaho, në pozicionin "*Drejtor*" në Drejtorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;

Për 3 rastet e tjera vijon e njëjta situatë.

Në **pikën 7** Komisioneri ka kërkuar që të anulohet procedura e dhënies së masës disiplinore, “*Vërejtje*”, për disa nëpunës, e cila është dhënë në kapërcim të kompetencave nga ana e Kryetarit të Bashkisë Divjakë dhe të përsëritet procedura.

Rezulton se, me Urdhrin nr. 395, datë 4.10.2024, të Kryetarit të Bashkisë, është ngritur Komisioni i Disiplinës. Ky Komision, me aktin nr. 8757/12 prot., datë 31.12.2024, ka ndërprerë ecurinë disiplinore për nëpunësit *Ada Lapi, Andi Bullari, Endrit Mebelli, Elvana Mileti, Jurisa Lala, Lesintja Trungu, Petrit Toska* dhe *Irena Kajo*.

Ndërsa për Renato Bregu, konstatojmë se Komisioni i Disiplinës nuk ka marrë masa për ndërprerjen e ecurisë disiplinore pasi me Urdhrin nr. 425, datë 15.11.2024, “*Për Largim nga Detyra*”, të Kryetarit të Bashkisë, i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare në pozicionin “*Inspektor i taksave dhe tarifave vendore në NJA*” më herët se akti i nxjerrë nga ky komision.

Në **pikën 8**, Komisioneri ka rekomanduar njësinë përgjegjëse të luajë rol aktiv dhe të aplikojë të gjitha mjetet proceduriale që i njuh ligji, duke treguar kujdes të veçantë gjatë aplikimit të institutit të rekrutimit.

Në lidhje me këtë detyrë me karakter rekomandues, nga ana e njësisë përgjegjëse u deklarua se procedurat e rekrutimit në shërbimin civil janë kryer në përputhje me ligjin dhe një kopje e tyre janë dërguar për vlerësim pranë inspektorit të Komisionerit që monitoron këtë subjekt nëpërmjet mbikëqyrjes online.

Në **pikën 9**, Komisioneri ka kërkuar nga njësia e burimeve njerëzore që të ndërmarrë hapat e kërkuar ligjor, në përditësimin dhe plotësimin e dosjeve të konkurrencës dhe dosjeve të personelit me dokumentacionin e nevojshëm. Gjithashtu, nga ana e saj kërkohet që në vijimësi të garantojë ligjshmërinë e procedurave dhe në rast të mospërbushjes së detyrimeve nga personat përgjegjës, të marrë masat për të evidentuar përgjegjësinë dhe për të rregulluar pasojat, duke propozuar masa disiplinore për personat përgjegjës për moszbatimin e ligjit.

Në lidhje me zbatimin e kësaj pike, gjatë verifikimit në subjekt, grupi i punës i Komisionerit ka përzgjedhur në mënyrë rastësore 2 dosje, që i përkasin nëpunësve *Shaban Konja* dhe *Marinela Perriu*, të cilët aktualisht janë në periudhë prove, ku përveç akteve që vërtetojnë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme, rezultojnë se janë përfshirë në to edhe përshkrimet e punës, si dhe akti i emërimit si nëpunës civil në periudhë prove. Ndërkohë në dosjen ku është materializuar e gjithë procedura e konkurrencës, për punonjësin në fjalë rezulton se janë administruar të gjitha aktet që vërtetojnë zhvillimin e kësaj procedure në përputhje me ligjin.

Për **pikat 9, 10, 11** dhe **12** të këtij vendimi ku Komisioneri kërkon trajnime specifike pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike për institute të ndryshme të ligjit, rezulton se:

Njësia përgjegjëse e Bashkisë Divjakë, me shkresën nr. 7778/1 prot., datë 08.11.2024, "Kthim përgjigje Shkollës Shqiptare të Administratës Publike", ka listuar tematikat për trajnime për vitin 2025, duke shënuar funksionet përkatëse të nëpunësve që paraqesin nevojë për trajnim.

Njëkohësisht, me anë të shkresës nr. 7631 prot., datë 22.07.2025, njësia përgjegjëse e institucionit, i është drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike me një listë tematikash mbi legjislacionin në shërbimin civil, duke përfshirë në këtë kërkesë 16 nëpunës të shërbimit civil me funksionet përkatëse.

Në pikën 13 të këtij vendimi kërkohet që të merren merren masat për plotësimin e dosjeve të personelit, për nëpunësit civilë që kanë depozituar vetëm vërtetime të lëshuara nga institucionet arsimore, duke siguruar diplomën origjinale ose të noterizuar dhe dokumentacionin e barasvlershëm sipas kërkesave ligjore, si dhe për plotësimin e dosjeve me raportin mjekësor në rastet ku ky dokument mungon.

Nga këqyrja në vend e dosjeve personale të nëpunësve rezultoi se ato ishin plotësuar me diplomat dhe listat e notave origjinale ose të noterizuara. Për raportin mjekësor u përzgjedhën 2 dosje, përkatësisht të punonjësve S. Shkoza dhe V. Leçini, nga ku rezultoi se këto akte ishin përfshirë në dosje.

Në përfundim, në bazë të të gjitha gjetjeve të paraqitura më sipër, vlerësoj se Bashkisë Divjakë, ka filluar zbatimin e vendimit paralajmërues Nr. 44, datë 24.07.2024, të Komisionerit, nëpërmjet veprimeve konkrete administrative, për të gjitha detyrat e lëna, por ende nuk e ka përfunduar atë. Problematika në këtë rast, qëndron kryesisht në drejtim të dy aspekteve të administrimit të shërbimit civil, që kanë të bëjnë me procesin e vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil dhe rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin, edhe pse, nga institucioni janë marrë masa për t'i nisur dhe zhvilluar këto procese, por ende ato nuk janë finalizuar me akte përfundimtare.

Në kushtet kur këto procese kanë një nivel kompleks vështirësie që kërkon njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore si edhe kapacitete të mjaftueshme në përbërje dhe mbështetje të njësisë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore të institucionit, të cilat janë të kufizuara në njësitë e administratës vendore, e sidomos në këto bashki me një numër relativisht të ulët banorësh, e po kështu, duke njohur faktin se këto procese kërkojnë një periudhë kohore relativisht të gjatë për t'u implementuar, si për shkak të afateve procedurale, ashtu edhe për arsye të ndryshme objektive, që kryesisht qëndrojnë në mungesën e kandidatëve të interesuar për të marrë pjesë në procesin e rekrutimit, vlerësojmë se për realizimin e detyrave, institucionit duhet t'i mundësohet një afat kohor që shkon përtej atij të vendosur nga Komisioneri në vendimin e paralajmërimit.

Me synim plotësimin e detyrave të lëna në vendim, në koherencë edhe me zhvillimet aktuale, që përkojnë me hartimin e strukturave të reja organizative të njësisë të administratës vendore për vitin 2026, si edhe me qëllim që këto institucione të mbështeten me asistencë teknike si nëpërmjet trajnimeve nga ASPA, ashtu edhe nga stafi i

Komisionerit, për të zbatuar drejt kërkesat e ligjit dhe procedurat ligjore rast pas rasti, vlerësojmë se ndjekja e procesit të rivendosjes së ligjshmërisë, përgjatë vitit 2026, duhet të vijojë përmes mbikëqyrjes online dhe mbikëqyrjes së orientuar për implementimin e skemës së administrimit të shërbimit civil në përbërje të strukturës organizative në njësitë e vetqeverisjes vendore, të cilat janë procese që aktualisht realizohen nga stafi i Komisionerit, përgjatë gjithë vitit kalendarik.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar).

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr.54, datë 27.09.2024, të Komisionerit, "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në Bashkinë Divjakë*".
2. Ndjekjen e detyrave të pazbatuara, të evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, përmes mbikëqyrjes online dhe, në varësi të ecurisë, nëse shkeljet nuk adresohen plotësisht, institucioni të jetë objekt i procedurës së mbikëqyrjes së përgjithshme apo tematike gjatë vitit 2026.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Divjakë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

